

## **Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit zhvillon analizën vjetore për vitin 2021**

Me datë 11 shkurt 2022, Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit zhvilloi analizën vjetore për vitin 2021. Në këtë aktivitet morën pjesë Drejtoresha e Përgjithshme e Kontrollit të Lartë të Shtetit, znj.Marjola Llanaj, Drejtori i Departamentit z.Vullnet Karafilaj dhe audituesit përkatës të këtij departamenti.

Në fokus të kësaj analize ishte veprimtaria audituese e departamentit përgjatë vitit 2021, konkretisht në realizimin e planit vjetor, gjetjet e konstatuara, masat e rekomanduara si dhe sfidat dhe pritshmëritë për vitin 2022.



Në fjalën e çeljes së këtij aktiviteti, Drejtoresha e Përgjithshme znj.Marjola Llanaj vuri theksin mbi rëndësinë e punës audituese që kryen Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit në institucionet e kadastrës, në veçanti në dhënien e rekomandimeve që sjellin një vlerë të shtuar në përmirësimin e shërbimit kadastral, një temë kjo që ka një ndjeshmëri të lartë për qytetarët shqiptarë. Në këtë kuadër, znj.Llanaj nënvizoi rëndësinë e rritjes së mëtejshme të cilësisë së auditimit dhe fokusimin me auditim në tematika, të cilat përbëjnë problemet kryesore të çështjes së shumë diskutuar të pronave në Shqipëri, me qëllim që KLSH të jetë një kontribues aktiv përmes masave që rekomandon në këtë drejtim.

Nga ana e Drejtorit të Departamentit, z.Vullnet Karafilaj u prezantua e gjithë korniza e veprimtarisë audituese, duke parashtruar të gjithë komponentët që kanë përbërë aktivitetin në drejtim të auditimeve në institucionet e kadastrës, të mjedisit dhe institucione të tjera. Z.Karafilaj vuri në dukje se viti 2021 shënon kurorëzimin me sukses të programit vjetor të auditimi, duke realizuar 21 auditime, ose 2 auditime më shumë sesa parashikimi fillestar prej 19 auditime të programit vjetor.

Përgjatë fjalës së tij, z.Vullnet Karafilaj u ndal tek roli aktiv që kanë patur auditimet në dhënien e masave rekomanduese, ku megjithëse në vitin 2021, puna audituese u ndesh me ndryshime të reja ligjore që prekën sferën e kadastrës dhe legalizimeve, Departamenti ka vijuar të rekomandojë masa ligjore dhe organizative, të cilat në gjykimin profesional do të ofronin një garanci reale për mbrojtjen e pronës publike dhe shtetërore nga veprimet e paligjshme.

Në përfundim të fjalës së tij, z. Karafilaj veçoi edhe rolin e Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit në evidentimin dhe vlerësimin e shkeljeve të rënda, për të cilat janë konstatuar elementë të veprave penale, si shpërdorim detyre apo shkelje e pabarazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike, duke marrë masa për referimin e të tilla rasteve në SPAK apo në prokuroritë e rrethit përkatës. Konkretisht, Departamenti, në bashkëpunim edhe me Drejtorinë Juridike, ka përgatitur 10 kallëzime penale, në cilësinë e titullarit të institucionit, Drejtorit, Regjistruarit, përgjegjësit të sektorit dhe specialistit.

Analiza Vjetore e Departamentit u konceptua edhe në formën e një forumi diskutimi, ku katër auditues përgatitën prezantime me tema në problemet pronësore dhe menaxhimit të aseteve, për t'u përmbyllur me parashtrimin e sfidave dhe pritshmërive për vitin 2022, me qëllim rritjen e cilësisë së auditimit.